



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 1254 Prot.

Tiranë, më 18.05.2026

**SHPLLJE NJOFTIMI PËR 1 (NJË) VEND TË LIRË PUNE NË QENDRËN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE POGRADEC**

Në zbatim të ligjit nr. 111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Urdhrit të Kryeministrit nr.47, datë 13.03.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 21, datë 01.03.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas shpall procedurën e rekrutimit për vendin e lirë si më poshtë vijon:

- **Punonjës me trajnim të posaçëm**, Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec (1 pozicion)
- **Kategoria e pagës**: IV-2
- **Vendndodhja**:

Qendra	Vendndodhja
Pogradec	Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

- **Lloji i punës**: Punë me kohë të plotë.
- **Kohëzgjatja e kontratës**: Kontratë me kohëzgjatje deri në rikthimin nga leja e lindjes e punonjësës aktuale.

Qendra e Ofritit Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Qendra (Qendra e ofritit të shërbimit të ndhmës juridike parësore ) është një njësi e specializuar për dhënie ndhmës juridike parësore, e organizuar si “**njësi e drejtpërdrejtë e ofritit të shërbimeve**”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, e cila ofron shërbimet ndhmës juridike falas duke garantuar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

**Kërkesa të posaçme**

**Kualifikime: Specialist (Jurist-Qendra)** pranë qendrave është punonjësi i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi (*master shkencor ose profesional*), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndhmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndhmës juridike parësore.

**Eksperienca**: Jo më pak se 1 (një) vit eksperiencë në punë si **jurist/avokat**.

## Detyrat Kryesore

### **Specialist (Jurist-Qendra) i qendrës jep ndihmën juridike parësore nëpërmjet:**

1. Dhënies së informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor.
2. Dhënies së këshillimit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.
3. Dhënies së këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve (ndërmjetësim, arbitrazh).
4. Dhënies së ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
5. Përfaqësimit përpara organeve administrative;
6. Dhënies në të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

### **Specialist (Jurist-Qendra), ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore, detyrohet:**

- a) Të asistojë çdo person që drejtohet pranë Qendrës me një kërkesë për ndihmë juridike.
- b) Të ndihmojë kërkuuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike parësore; dytësore si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore;
- c) Të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike me cilësi sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë me Udhëzimin e miratuar “Për kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike”;  
Të raportojë çdo muaj ose me kërkesë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas lidhur me rastet dhe ecuritë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, duke i bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës që provon kryerjen e shërbimeve të ofruara sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrisë së Drejtësisë;
- d) Të bashkëpunojë me Drejtorinë së Ndihmës Juridike Falas për promovimin e sistemit të ndihmës juridike parësore përmes zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese/edukimit ligjor të publikut;
- e) Të bashkëpunojë me ofruesit e tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore në kuadër të referimit të rasteve për ndihmë juridike;
- f) Të respektojë etikën dhe komunikimin me qytetarët që drejtohen pranë Qendrës;
- g) Të kryejë shërbimin e plotë të ndihmës juridike dhe të mos heqë dorë nga ofrimi i shërbimit përveç rasteve të konfliktit të interesit apo për shkaqe të tjera të arsyeshme. Nëse ka shkaqe për mosofrim ose ndërprerje të shërbimit, ai njofton menjëherë Drejtorinë së Ndihmës Juridike Falas, e cila merr masa për një ofertues alternativ për çdo rast.
- h) Të kryejë të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

### **Aftësi të tjera**

- Të ketë aftësi analitike;
- Të jetë i aftë të marrë vendime dhe të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

## Fusha e Njohurive

- Të ketë njohuri të thelluara mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Ligjin nr.111/2017, kushtet dhe kërkesat e ligjit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës juridikefalas;
- Të ketë njohuri të plota teorike dhe praktike mbi legjislacionin dhe të drejtën civile, penale dhe administrative.

## DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat (*në format të njehsuar me originalin*) si më poshtë:

1. Kërkesë për pozicionin;
2. Jetëshkrim i aplikantit (CV, sipas formatit të europass);
3. Diplomë (përfshirë edhe diplomën bachelor);
4. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj (*certifikata; trajnime; gjuhë e huaj; aftësi kompjuterike; artikuj shkencorë etj.*)

Dokumentat duhet të dorëzohen **me postë** në Zyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas **brenda datës 31.05.2026.**

*Mos përcjellja e dokumentacionit të kërkuar passjell skualifikimin.*

**Adresa:** Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Rruga "Jordan Misja", Njësia Bashkiake nr. 9, Godina nr. 3, Tiranë

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
(Në mungesë)

**DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE**

**Patricia Pogaçe**

